



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KESHILLI I BASHKISË

Nr. 6283 Regj.

Ballsh, më 20.12.2022

VENDIM

Nr. 66 Datë 19/12 2022

“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare Z Xhevair Rrapaj, banorë të fshatit Ninësh, Njësia Administrative Fratar, Bashkia Mallakastër, banesa (një katë) e cila është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 18.03.2022 ”.

Baza ligjore

- Ligji Nr.139/2015 date, 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore".
- Ligji Nr.107/2016 date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut".
- Ligji Nr.45, date 18.07.2019 "Per Mbrojtjen Civile".
- V.K.M. nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat dhënies se ndihmës shtetore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër për mbështetje financiare të qytetarit Xhevair Rrapaj, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e zjarrit të rënë më datë 18.03.2022.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të administruar nga ana e Bashkisë Mallakastër.
3. Miratimin e vlerës totale prej **293.300 (dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind) lekë**. dëme në orendi shtëpiake.

Miratimin e vlerës në masën prej **50 %**, **144.719 (njëqind e dyzete e katër mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekë**, e vlerës totale prej **289.439 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) lekë**, dëme nga ana ndërtimore.

Totali i vlerës (nga ana e orendive shtëpiake + 50 % nga ana ndërtimore pa TVSH) është 438.019 (katërqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëmbëdhjetë) leke.

4. Vlera e dëmit është përlogaritur nga Komisioni i Vleresimit të dëmeve, i ndryshuar të Bashkisë Mallakastër, ngritur me Urdhër nr.375 datë 11.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.
5. Bazuar në ligjin 45, datë 18.07.2019 neni 41 "E drejta e kompesimit", pika 2, në të cilën thuhet "Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile."
6. Ndihma financiare për familjen e qytetarit Xhevair Rrapaj përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat dhenies se ndihmes shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore". Bazuar ne përputhje me çmimet aktuale mesatare të investiguara nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier "Çmimet e investiguara për mobilje, elektroshtëpiake, çmimet sipas zërave të punës nga ana ndërtimore".

KRYETAR

Fitim Baraj

